**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
**Ministria për Forcën e Sigurisë**
**Ministarstvo za Snaga Bezbednosti Ministry for Security Force**

# NJOFTIM PËR KONTRATË

**PUNË**

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Data e përgatitjes së njoftimit: 02.11.2016**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **21700** | **16** | **094** | **521** |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar: Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës** | | |
| **Adresa Postare: Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë- Mitrovice, Prishtinë, RKS** | | |
| **Qyteti: Prishtinë** | **Kodi postar: 10000** | **Vendi: Republika e Kosovës** |
| **Personi kontaktues: Afrim MAXHUNI** | | **Telefoni: 038 200 13 500** |
| **Email: afrim.maxhuni@rks-gov.net** | | **Faksi: 038 200 13 501 ose 2** |
| **Adresa e Internetit (nëse aplikohet):** | | **"[shëno web e AK]"** |

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Po ☐ Jo ☒

**Nëse po**, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
Ndërtimi i poligonit për stërvitje taktike në kazermën e Ferizajt( projekti është i ndare në dy faza 2016 dhe 2017)

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

| ☒ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☒ Plani dhe ekzekutimi | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing) | |

| | | |
|---|---|---|
| ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |
| Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve<br>Kazerma e FSK-së në Ferizaj | Vendi kryesor i dorëzimit<br>________________________<br>______________________ | Vendi kryesor i realizimit<br>________________________<br>______________________ |

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë **Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator ☐

Kontrate publike kornizë me disa operator ☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi ☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë ☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj** ________

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**

**Qellimi i i kontrates është kontraktimi i nje operarot ekonomik i i cili do te beje e Ndërtimi i poligonit për stërvitje taktike në kazermën e Ferizajt( projekti është i ndare në dy faza 2016 dhe 2017) , sipas pershkrimi teknik me te dhenat detal jane te perfshira ne projktit te cilen do marrin te gjithe operatore ekonomik te intresuar**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45**

**II.1.7) Variantet pranohen** **Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë** **Po** ☐ **Jo** ☒

**Nëse po,** tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.I.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve** (nëse aplikohet)**: NA**

**Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: [shëno numrin]**

**II.1.10) Informacione lidhur me pjesët** (nëse aplikohen)

| Nr. i pjesës | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|
| | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës:**

**2016: 28,500.00 €uro**

**2017: 80,000.00 €uro**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)

Poligoni për stervitje taktike përbëhet prej katër pistave stërvitore të cilat lidhen me të ashtuquajturin rrethi grumbullues. Pistat janë emruar me sa vijon:

- Pista e kuçe
- Pista e bardhë
- Pista e kaltërt dhe
- Pista e zezë

Çdo pistë ka nga gjashtë pengesa të cilat janë të projektuara të punohen kryesisht me material druri të impregnuar. Forma, dimensionet dhe mënyra e lidhjes së tyre do të bëhet e till që nuk paraqet rrezikshmeri për lëndime serioze në fazën e përdorimit të poligonit.

- Pistat do të punohen në formë rrugësh, rrugicash me dimensione sipas nevojës, dhe në teren sa më natyral. Pra, shtegu i pistave do të pastrohet nga vegjetacioni, shkurret, therrat dhe nga vegjetacion që paraqet penges në zhvillimin e aktiviteteve. Drunjët me diameter më të madh se d=10 cm të ruhen në mënyrë sa më racionale duke devijuar pistën sepse pista nuk është e nevojshme të jetë strikte. Vlen të thesohet që pishat që gjende në sipërfaqen ku do të ndërohet poligoni të mos dëmtohen në asnjë mënyrë.
- Meqë tereni është i pjerrët niveleta gjatësore e pistave do të jetë punohet sipas gjendjes në teren. Nivelizimi dhe gërmimi i terenit do të bëhet vetëm për të përshtatur terenin për vendosjen e pengeses adekuat dhe po ashtu qasjne nga pista ne pengesë.
- Pjesa me e madhe e pengesave do të vendosen në sipërfaqe të rrafshët, varësisht prej llojit të pegesës (shih detalet grafike)
- Hapja e vrimave për ankerimin e drujve në tokë të bëhet me turiela diameter adekuat në mënyrë ë stabiliteti i tyre të jetë i duhur.
- Megjithëse, në projekt janë dhënë koordinatat e vend punimit të pengesave, varësisht prej gjendjes në teren ato mund të zhvendosen për distanca të vogla në poz me te pershtatshem ne pajtim me organin mbikqyres, por çvendosjet të mos ndikojnë në zvoglimin apo rritjen e distancave në mes të pengesave.
- Pengesat të punohet të rënditura sipas projektit dhe me materilet adekuat siq janë paraqitur në projektin grafik si dhe përshkrim teknik.
- Imprengmi i drurit nënkupton mbështjelljen e drurit me substance kimik e quajtur TANALITH, ky kemikat eshte mbrojtës I drurit ne kontakt me token dhe ka permbajtje te bakrit dhe bor me shtesa. Një m3 dru duhet te absorboj 6.5 kg substance kimike të koncentruara gjatë procesit.

  Materiali i përdorur dru i impregnuar (ngopur) do përpunohet në proces adekuat nëpër përbërje kimike: bakri, bor tebuconazol, propiconazole. Jetëgjatësia e drurit të trajtuar në këtë process do të jetë 25-30 vjet. Kjo përbërje mbulon tërë spektrin e kërpudhave dhe insekteve.

  Druri i përpunuar dhe trajtuar me këtë metod ka një process të caktuar dhe makineri adekuate për prandaj duhet të

  Kjo ngopje korrespondon me standardet evropiane; EN 599 - 1 EN 335 - 1 EN 351 – 1.

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja 160 ditë (nga nënshkrimi i kontratës)

FILLIMI: Pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Projektit dhe Operatorit Ekonomik dhe menaxheri i projektit, brenda 5 ditëve të punës, do ta përcjell një kopje të planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Dhe pasi qe Zyrtari i Prokurimit ka pranuar planin për menaxhimin e kontratës, do t'i lëshojë Operatorit Ekonomik, letrën e fillimit te punëve

PËRFUNDIMI:
Përfundimi i punëve sipas planit dinamik te ofruar nga Operatorit Ekonomik dhe te aprovuar nga Autoritetit Kontraktues,

**NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**

**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN**

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit** **Po** ☒ **Jo** ☐

**Nëse po**, vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës me kohëzgjatje plani dinamik plus 30 ditë

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** (nëse aplikohet):

______________________________

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës** **Po** ☒ **Jo** ☐

**Nëse po,** përshkrimi i kushteve të veçanta

1. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënia te kontratës para nënshkrimit te kontratës duhet te sjelle kontratën mbi sigurimin e vend ndërtimi nga një kompani e licencuar dhe e njohur e sigurimeve. Sigurimi duhet të mbulojë: për automjetet: dëmtimet ndaj palëve të treta; për personat: lëndimin trupor, dëmtimin e shëndetit, vdekjen e punëtorit apo personit të tretë; për pasurinë: humbjet apo dëmtimet e pajisjeve, materialeve dhe dëmtimin e pronës apo pasurisë së personave të tretë. Origjinali i polices së sigurimit të vend ndërtimit duhet të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga një kompani e licencuar dhe e njohur të sigurimeve

2. Implementimi i punimeve në objekt të behën në harmoni me ligjet ne fuqi të Republikës së Kosovës, e në raste kur ato mungojnë, atëherë të te aplikohen standardet të BE-së

3. Operatori Ekonomik i cili do te realizoj projektin, merr përsipër rregullimin e infrastrukturës , kthimin ne gjendjen e mëparshme ne rast te dëmtimit gjate realizmit te punëve origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik --duhet te dorëzohet para nënshkrimit të kontratës vetëm nga kompania fitues

4. Garancion për punët e kryera nga kontraktuesi duhet është minimumi një (1) vite nga momenti

i pranimit teknik te objektit

5. Garancion për konstruksion e kryera nga kontraktuesi duhet është minimumi dhjete(10) vite nga momenti i pranimit teknik te objektit

6. Plani dinamik i realizimit të punëve, (koha e realizimit të llogaritet në ditë kalendarike Kompania fituese para nënshkrimit të kontratës duhet të dorëzoj planin dinamik detal me aktivitetet, numrin e punëtorëve e stabilimentet (metodologjia) të cilit kompania do të i përmbahet.

7. Te gjitha materialet dhe punimet ne objektet e FSK duhen te realizohen ne përputhshmëri te plotë me standardet ndërtimore "EC" si dhe me standardet ISO

8. Forma e pranimit ( kontraktimi ) te objektit "sipas projektit dhe specifikave

9. Kontraktuesi mundet ti nënshtrohet procesit te verifikimit sipas legjislacionit ne fuqi, nëse një gjë te tille kërkohet nga Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi obligohet te ofroje dokumentacioni e nevojshëm për verifikim.

10. Detajet tjera rrethe implementimit kontratës do të caktohen me menaxheret e kontratës.

**III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

**III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**

**Kërkesa 1:** Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.

**Kërkesa 2:** Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

**Kërkesa 3:** Vërtetimin nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

**Evidenca 1:** Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O.Ekonomik

**Evidenca 2:** Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal

**Evidenca 3:** Vërtetimin nga Gjykata themelore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal

**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**

**Kërkesa 4.** Certifikata e regjistrimit të biznesit

**Kërkesa 5.** Certifikata e regjistrimit të TVSH-së

**Kërkesa 6.** Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
**Evidenca 4.** Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit
**Evidenca 5.** Kopja e Certifikatës e TVSH-së
**Evidenca 6.** Kopja e Certifikatës me numër fiskal (kopje).

**III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**
**Kërkesa 7.** Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj te hyrat e përgjithshme se bashku për tri vitet e fundit( 2013,2014,2015) duhet te jene minimum 200,000.00 €.
**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**
**Evidenca 7.** Raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar – duhet te dorëzohet ne origjinal

**III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**
**Kërkesa 8.** Operator Ekonomik duhet te dëshmoj kapacitetin e fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim :Emri , mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca(vite) dhe pozicioni në kompania.
**Kërkesa 9.** Kërkohet minimumi staf Professional dhe menaxherial:
•inxh.Dipl. i Arkitekturës (apo master/ jo bachelor) ose inxh.Dipl. i Ndërtimtarisë -konstruktiv (apo master / jo bachelor) min. 1, me përvojë 3 vjeçare
•inxh.Dipl. i Elektroteknikës (apo master/ jo bachelor) min. 1, me përvojë 3 vjeçare

Operatori Ekonomik duhet te caktoj një menaxherin të projektit nga stafi profesional , i cili duhet të një me përvojë 5 vjeçare, mundet te jete njeri nga stafi profesional i prezantuar;( shembull: nga dy inxhinieret e kërkuar te arkitekturës njeri nga ta mund te caktohet)

**Kërkesa 10.** Operator Ekonomik duhet te dëshmoj se ka realizuar kontrata gjate tri viteve te fundit 2013, 2014 dhe 2015, ne lëmin e ndërtimit dhe punëve te ngjashme, me institucion publike dhe private, me min volum 150,000.00€,
**Kërkesa 11.** Raporti për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore për min:

1. Kamion 12 ton (1 copë )
2. Ngarkues (1 copë )
3. Cilindër për ngjeshje (1 copë )
4. Mjete te tjera te punës ne baze te specifikave te projektit

**Kërkesa 12.** Të prezantohet plani dinamik i realizimit të punëve ne jo me shume se 160 nga momenti i nënshkrimit te kontratës ( hyrjes ne fuqi te saj)

Dëshmia e kërkuar dokumentare
**Evidenca 8.**
Një pasqyrë tabelore e personelit: Emrin, mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca(vite) dhe pozicioni në kompani . duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik

**Evidenca 9.**
Të prezantohet dëshmi për stafin profesional si :

- Diploma e noterizuar nga origjinali( diplomat duhet te dorëzohen të noterizuar në origjinal),
- CV-it- duhet të dorëzohen në origjinal ose të noterizuar nga origjinali,

- Deklarata e ekskluzivi tetit dhe Disponueshmërisë sipas aneksit 7 ne dosjen e tenderit – duhet të dorëzohet në origjinal.

Të ofrohet Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit (mundet te jete njeri nga stafi profesional i prezantuar)– duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik

**Vërejtje:**

Stafi i kërkuar duhet të posedojnë titullin e lartshënuar ose të jenë master të drejtimeve përkatëse, nuk pranohet të jene bacheler

**Evidenca 10.**

Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të realizuara gjate tri viteve te fundit në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, te dëshmuar me referenca ose pranim teknik të punëve, në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës , te kryera ne lëmin e ndërtimit dhe punëve te ngjashme, me minimum volum 150,000.00 €, te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimit dhe vendin e realizimit të shërbimeve projektues – asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve teknike.

Nëse te kryera ne lëmin e ndërtimit dhe punëve te ngjashme janë kryer për kompani private duhet te dëshmohet me pasqyra bankare – pasqyrat bankare duhet te prezantohen ne origjinal nga ndonjë banke e licencuar

**Evidenca 11.** Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike, për te cilat është kërkuar dhe të cilat i ka ne dispozicion kompania, duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur; ose kontrata mbi marrjen me qera të pajisjeve, me emër të projektin në fjale, e cilat duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga te dy palët

Dëshmi për pajisjet :

•Libreza e regjistrimit të automjeteve te cilat regjistrohen duhet te jete me validitetit- kopje

•Për automjetet të cilat nuk regjistrohen duhet ti bashkëngjiten DUD doganor të lexueshëm- kopje

•Për pajisjet te cilat nuk kanë Libreza apo DUD-a duhet te sillet fatura e blerjes – kopje

**Evidenca 12.** Plani dinamik i realizimit të punëve për të dy fazat 2016 -2017, plani dinamik duhet të përmbaj aktivitete kryesore te punëve ne baze te specifikave të projektit duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik

**III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE**

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar** **Po** ☐ **Jo** ☒

**Nëse po,** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve** **Po** ☐ **Jo** ☒

**NENI IV: PROCEDURA**

**IV.1) LLOJI I PROCEDURËS**

| **IV.1.1) Lloji i procedurës** |
|---|
| ☒ **E hapur** |

☐ E kufizuar

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** (procedurë konkurruese me negociata)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar **Po** ☐ **Jo** ☐

Autoritetet kontraktuese do të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

IV.1.4) Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është :

**IV.2) KRITERET E DHËNIES**

☒ **tenderi i përgjegjshme me Çmimin më të ulët**

**IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE**

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë** **Po** ☐ **Jo** ☒

**Nëse po,**

Njoftim paraprak: ______________________

Publikime tjera (nëse aplikohen): ______________________

**IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit**

Afati i fundit për marrjen e dosje se tenderit deri me date 21/11/2016 , ora 15:00.

Kërkesat për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që shpien drejt dhënies së ndonjë kontrate publike, mund të paraqiten në mënyrë elektronike,

Dokumentet me pages **Po** ☐ **Jo** ☒

**Nëse po**, çmimi ______________________

Kushtet dhe metoda e pagesës: ______________________

**IV.3.3) Afati i fundit për pranim të tenderëve**

**Data 23.11.2016 Koha 13.00h Vendi Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë-Mitrovice, Prishtinë, RKS**

| |
|---|
| **IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:**<br>☐ po ☒ jo<br><br>**Nëse po**, jep arsyetim ______________________ |
| **IV.3.5)** A është e nevojshme siguria e tenderit: **Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>**Nëse po**, vlera e sigurisë së tenderit 2,000.00 €<br><br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muaj 3 |
| **IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:** ditë 60 apo muaj 2 |
| **IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br>**Data 23.11.2016 Koha 13.30h Vendi Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë-Mitrovice, Prishtinë, RKS** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br><br>Ne rast mos përputhje mes gjuhëve dominon gjuha Shqipe |